

## PLANI I VEPRIMIT PËR VAZHDIMËSINË E SHËRBIMIT NDAJ KLIENTËVE (i rishikuar)

Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia e COVID-19, në zbatim të Aktit Normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19", të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe në zbatim të akteve të brendshme të shoqërisë ALBSIG JETË, Shoqëria ALBSIG JETË ndermerr masa për vazhdimësinë e shërbimit ndaj klientëve, si më poshtë.

1. Shoqëria ALBSIG JETË do të vazhdojë aktivitetin e saj për të ofruar shërbimin e nevojshëm ndaj klientëve, përmes pikave të shërbimit ndaj klientëve në qendër e degë dhe sistemit online.

2. Aktiviteti i shërbimit ndaj klientit do të bëhet sipas kërkesave, kushteve dhe orareve të përcaktuara nga organet kompetente shtetërore që menaxhojnë situatën e krijuar. Punonjësit që do të jenë në pikat e shërbimit ndaj klientëve duhet:

- a. Të zbatojnë instruksionet që vendosen e publikohen nga organet e ngarkuara për menaxhimin e pandemisë të shkaktuar nga COVID-19.
- b. Të pajisen me mjetet e dezinfektimit në hyrje të cdo zyre (për klientin) si dhe cdo punonjësi t'i mundësohen mjetet dezinfektuese.
- c. Të kryejnë testin serologjik në periudha periodike 2 – javore dhe shpenzimet do të mbulohen nga ALBSIG JETË sh.a.
- d. Për stafin e evidentuar me COVID – 19 pas kryerjes se testit sipas pikes (c) udhëzohet qëndrimi në shtëpi dhe ofrimi i shërbimit online për klientin.
- e. Të dezinfektojnë mjetet e punës me mjetet e dezinfektimit;
- f. Të mos lejojnë praninë e më shumë se një personi që i ofrohet shërbim;
- g. Të përdorin maska mbrojtëse dhe doreza si dhe mjetet e dezinfektimit;
- h. Të respektojnë distancën e kërkuar me klientin dhe në çdo rast jo më afër se 2 m;
- i. Të udhëzojnë klientët të qëndrojnë në distancë të largët nga njëri-tjetri dhe të eliminojnë çdo kontakt fizik me ta;
- j. Të trajtojnë me kujdes çdo dokument që marrin nga klientët për të mos u infektuar;
- k. Të vendosin njoftime të dukshme për respektimin e distancës së sigurisë nga klientët.

3. Sistemi online duhet të jetë funksional pa ndërprerje për t'iu aksesuar shërbimin klientëve në shitjen e policave, raportimin e dëmeve si dhe ankesat.

4. Adresa e Internetit të shoqërisë ALBSIG JETË të mundësojë informacion sa më të zgjeruar për klientët dhe personat e tjerë të interesuar për produktet, shërbimet dhe informacione të tjera që publikohen në faqe.

5. Ky planveprimi zbatohet deri në përfundim të epidemisë dhe rishikohet për t'u përshtatur me situatën e pandemisë të shkaktuar nga COVID-19.

